



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Aplikimi i pagesave të studentëve në Universitetin e Prishtinës

NUMËR: MASHT, 3 /2008

DATË : 19.03. 2008

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 19/2001, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, të nenit 25 paragrafi 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, nenit 18.2 paragrafi c), nenit 28 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës si dhe nenit 215 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më tutje MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është që të përcaktojë pagesat për shkollim dhe tarifat tjera që paguhen nga studentët të cilët studiojnë në Universitetin e Prishtinës për vitin akademik 2008/2009.
2. Mjetet e grumbulluara nga pagesat studentëve do të shfrytëzohen për tri qëllime kryesore:
 - a) Bursa dhe përfitime tjera për studentë;
 - b) përmirësimi i kushteve të punës në Universitet dhe
 - c) pagesa për stafin akademik dhe për aktivitete studentore.

Neni 2

Tarifat e shkollimit dhe pagesat administrative

Universiteti i Prishtinës do të realizoj pagesat për shkollim dhe pagesat administrative nga studentët për vitin akademik 2008/2009 dhe atë:

1. Pagesat për semestër për studentët e rregullt, në nivelin ‘Bachelor’:
 - a) pagesa për regjistrimin e semestrit dimëror ----- 50 €
 - b) pagesa për regjistrimin e semestrit veror----- 50 €

2. Pagesa për semestër për studenët me korrespondencë në nivelin ‘Bachelor’ ----- 250 €

3. Pagesa për semestër për studimet postdiplomike-Master ----- 200 €
 - a) pagesa për mbrojtjen e diplomës të studimeve-Master ----- 200 €

4. Pagesa për mbrojtjen e temës së magjistraturës----- 400 €

5. Pagesa për semestër për studimet e doktoraturës ----- 300 €
 - a) pagesa për mbrojtjen e disertacionit të doktoraturës ----- 500 €

Neni 3

Pagesat administrative

Studentët paguajnë edhe për këto shërbime administrative:

1. për provim pranues ----- 10 €
2. për secilin provim plotësues për regjistrimin e studimeve pasdiplomike----- 20 €
3. për provimin e studimeve Master----- 5 €
4. për certifikatë të notave ----- 5 €
6. për certifikatë të diplomës ----- 10 €
7. për indeks duplikat ----- 50 €
8. për secilin provim të pranuar në rastin e transferimit ----- 5 €
9. për diplomë ----- 20 €
- 10.për diplomë duplikat----- 50 €

11. për ndërrim fakulteti-departamenti -----	40 €
12. për përsëritje të provimit -----	10 €

Neni 4 **Afati**

1. Këto pagesa për shkollim dhe pagesa administrative të caktuara në këtë Udhëzim Administrativ vlejné për vitin akademik 2008/2009.
2. Të gjitha pagesat do të rishikohen për çdo vit nga MASHT-i, në konsultim me MEF dhe Universitetin.

Neni 5 **Përbjashtimet**

1. Studentët të cilët nuk kanë mundësi ekonomike të financojnë studimet e tyre duhet të paraqiten për asistencë. Për të ofruar këtë asistencë do të përpilohet skema nga MASHT-i dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
2. Për përcaktimin e kategorive të studentëve të cilët mund të përfitojnë këtë asistencë do të përpilohet një udhëzim administrativ nga MASHT-i.
3. MASHT-i do të nxjerr Udhëzim Administrativ lidhur me krijimin dhe funksionimin e skemës për dhënie të bursave studentëve më të mirë.

Neni 6 **Mënyra e pagesës**

1. Pagesat nga studentët do të bëhen në cilëndo bankë komerciale në Kosovë në emër të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës-Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-Universiteti i Prishtinës.
2. Studenti është i obliguar ta mbajë me vete dëftesën, si dëshmi për pagesën e kryer.

Neni 7

Kandidatët të cilët janë staf i UP-së lirohen nga pagesat administrative.

Neni 8

MASHT parasheh që në vitin akademik 2008/2009 ta rrisin numrin e studentëve në Programet e studimit që janë në pajtim me kërkesat e tregut të punës.

Neni 9

Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzim Administrativ pushojnë së vlejture të gjitha Udhëzimet Administrative dhe Anekset e nxjerrura më parë për rregullimin e kësaj çështje

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij me datën 01.06.2008.

Enver Hoxhaj , Ministër